

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11), dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/2019), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *kimi* për klasën VIII (e tetë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimorë në lëndën e *kimis* për klasën e VIII (tetë) të arsimit fillorë nëntë vjeçar bazohet në qëllimet/ rezultatet e pritura të parashikuara nga programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet në mënyrë të regullt në pajtueshmëri me planin mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar mësimor verifikohen tema të caktuara dhe njësi mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, me çka ruhet fondi javor i orëve të parashikuara me programin e regullt, gjegjësisht për lëndë mësimore me 2 orë në javë janë paraparë 64 orë me programin e shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësisë mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/ rezultatet e pritura, nocione të caktuara, metoda dhe aktivitete të përcaktuara në programin e regullt mësimor.

2. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

Tema 1. GJENDJA AGREGATE E MATERIES (5 orë)

Njësitë mësimore:

- Vetitë e gjendjeve agregate të materies
- Ndryshimet në gjendjen agregate
- Shtypja e gazrave
- Difuzioni

Tema 2. METALET DHE JOMETALET (9 orë)

Njësitë mësimore:

- Materialet e përditshme dhe vetitë e tyre
- Krahasimi i materialeve
- Materialet, vetitë e tyre dhe përdorimi
- Metalet dhe jometalet në sistemin periodik
- Metalet dhe legurat
- Shpjegim i vetitë e legurave

Tema3. SUBSTANCAT E THJESHTA,KOMPONIMET DHE PËRZIERJET (15 orë)

Njësitë mësimore:

- Elementet dhe atomet
- Simbolet kimike
- Emrat dhe simbolet kimike të elementeve
- Çka është komponim?
- Identifikimi i elementeve në komponime
- Substancë e thjeshtë apo komponim?
- Shpërbërja e komponimeve në substanca të thjeshta
- Paraqitja e komponimeve me ndihmën e formulave
- Substancat e thjeshta, komponimet dhe përzierjet
- Ndarja e përzierjes

Tema 4. REAKSIONET KIMIKE (28 orë)

Njësitë mësimore:

- Ndryshim fizik ose reaksion kimik?
- Shenja e ndryshimit kimik
- Reaktantë dhe produkte
- Ligji për ruajtjes e masës
- Përfitimi i oksideve
- Reaksionet me ujin
- Përfitimi i hidroksideve
- Përfitimi i klorureve
- Përfitimi i sulfateve
- Reaksionet e karbonateve
- Çka e mundëson torten që të rritet?
- Acidet dhe rreziqet
- Përdorimi i indikatorëve
- Përpunimi i indikatorëve vetanak
- Testimi i indikatorëve tuaj
- Indikator univerzal dhe shkalla e pH
- Përdorimi i inikatorit universal
- Reaksionet e neutralizimit
- Përdorimi i acideve dhe bazave
- Parandalimi i ndryshkjes

Tema 5. HYRJE NË KIMIN E KOMPONIMEVE TË KARBONIT (7 orë)

Njësitë mësimore :

- Hyrje në kimin e komponimeve të karbonit
- Emërtimi i alkaneve
- Vargjet homologe
- Lëndë djegëse fosile
- Lëndë djegëse alternative

3. Rekomandimet didaktike

Në programin e shkurtuar mësimor janë të përfshirë përmbajtje mësimore të caktuara të programit të rregullt mësimor të cilat në mes vedi janë në korelacion dhe formojnë një tërsi logjike. Në pjesën *Pasqyra e temave dhe njësit mësimore* janë dhënë tema të cilat janë përcaktuar në programin e shkurtuar mësimor dhe njësitë mësimore që kanë të bëjnë me përpunimin e përmbajtjes së re mësimore .

Për sejcilën temë , është dhënë numri i përgjithshëm i orëve që duhet realizuaar. Duke pasur parasysh se renditja e njësive mësimore i referohen zhvillimit të përmbajtjeve të reja mësimore, numri i mbetur i orëve në suaza të temës arsimtari i planifikon, organizon dhe realizon si orë për përsëritje, përforcim, ushtrime, kontrollim të diturive të nxënësive, sistematizim, eksperimente, hulumtim etj. Gjithashtu, një pjesë e këtyre orëve mund të përdoren për realizimin e një përmbajtje të caktuar mësimore gjatë dy orëve mësimore, e cila sipas vëzhgimeve të arsimtarit kërkon një kohë më të gjatë për realizim.

Gjatë mësimdhënies, është e nevojshme të realizohen orë mësimore për ushtrime. Me rëndësi të veçantë është zbatimi i metodës eksperimentale në zhvillimin e përmbajtjes, si dhe përdorimi i ilustrimeve, animacioneve, modeleve dhe të ngjashme.

Gjatë realizimit të mësimdhënies sipas programit të shkurtuar, duhet të merren parasysh drejtimet didaktike, dmth. format, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e regullt mësimor , të cilat u referohen njësive mësimore të përfshirane programin e shkurtuar mësimor.

4. Normativ për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtar në përputhshmëri me normativin për kuadër arsimor i dhënë në programin e regullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore *kimi* për klasën e VIII (tetë) të arsimit fillor nëntë vjeçar për vitin shkollorë 2020/21 e miratoi

Minister,

Mila Carovska